



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:233554

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05591624

C.nr.400/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.J nga Vushtrria, rruga ”..., tani me vendbanim të panjohur jashtë vendi-Austri, kundër të paditurave E.M nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, S.I nga Mitrovica, Xh.I nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë dhe N.B nga fshati ..., Komuna e Skënderajt, me objekt kontesti vërtetim pronësie, jashtë seance më datë 18.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me numër C. nr. 400/18 e datës 06.009.2018, e paditësit M.J nga Vushtrria, rruga ”..., tani me vendbanim të panjohur jashtë vendit, kundër të paditurave E.M nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, S.I nga Mitrovica, Xh.I nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë dhe N.B nga fshati ..., Komuna e Skënderajt, me objekt kontesti vërtetim pronësie, për shkak të mosdorëzimit të provave në ekzemplar të mjaftueshëm për palën e paditur.

A r s y e t i m

Paditësi M.J me adresë të fundit në Vushtrri, rruga ”..., me datë 06.09.2018 ka parashtruar padi, kundër të paditurave E.M nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, S.I nga Mitrovica, Xh.I nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë dhe N.B nga fshati ..., Komuna e Skënderajt, me objekt kontesti vërtetim pronësie.

Gjykata ka provuar që paditësit t’ia dorëzoj Aktvendimin C.nr.400/18 për plotësimin e padisë të datës 12.03.2024, në adresën e dhënë si në padi: Vushtrri, rruga ”..., por që fletë-kthesa e gjykatës

e datës 13.03.2024, u kthye me konstatimin e dorëzuesit se pala nuk gjendet në banesë, por me vendbanim të panjohur jashtë vendit-Austri.

Po ashtu, gjykata ka provuar që të autorizuarit të paditësit A.G, t'ia dorëzoj Aktvendimin C.nr.400/18 të datës 12.03.2024, por që fletëkthesa e gjykatës e datës 04.04.2024 është kthyer me konstatimin se i njëjti ka vdekur.

Gjykata me datë 04.05.2024, paditësit M.J, përmes tabelës së shpalljes së gjykatës, ia ka dorëzuar Aktvendimin C.nr.400/18 të datës 12.03.2024 dhe pas kalimit të afatit prej 7 ditësh, dorëzimi është konsideruar i kryer.

Andaj bazuar në të lartcekurat, e konform nenit 102 par.4 lidhur me nenin 116 par.6 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C. nr. 400/18, me datë 18.04.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.